

Përqasaje nocionesh

Lokucionet dhe njësitë frazeologjike foljore

Agim Spahiu

12 qershor 2002

Përmbledhje

Në këtë shkrim autori është marrë përgjithësisht me përcaktimin e disa kriterëve të cilat mundësojnë dallimin e këtyre dy njësive gjuhësore, pra të LOKUCIONEVE dhe FRAZELOGJIZMAVE. Këto kriterë mund të jenë të qëndrueshme jo vetëm për gjuhën shqipe, por edhe për gjuhët e tjera. Prandaj ftoj lexuesit që ta lexojnë këtë shkrim dhe ta përqëndrojnë vëmendjen në ato kriteret dalluese.

Lokucionet dhe njësitë frazeologjike, në përgjithësi, janë ndërtime gjuhësore të cilat e karakterizojnë individualitetin dhe origjinalitetin e çdo gjuhe. Ato përbëjnë një pasuri të madhe gjuhësore dhe konsiderohen ndër mjetet gjuhësore më shprehëse, më të fuqishme të një gjuhe. Madje nuk do të ishte e tepërt po të thuhet se sa më e pasur që të jetë një gjuhë me to, aq më e vlefshme për komunikim do të jetë për pjesëtarët e asaj shoqërie dhe anasjelltas.

Për fat të mirë, gjuha jonë është shumë e pasur me to. Por për studiuesit e tyre ende nuk ka përfunduar krejtësisht puna në vjeljen e tyre nga terreni dhe sidomos në trajtimin e tyre shkencor të gjithanshëm.

Në trajtimin e tyre shkencor, një nga detyrat e studiuesve të tyre duhet të jetë edhe çështja e pikëpërkimeve dhe e pikëdallimeve të tyre, sepse në literaturën tonë gjuhësore, por edhe në atë të disa gjuhëve të tjera, kjo çështje, sa e vështirë aq edhe e rëndësishme, nuk është shpjeguar sa e si duhet. Prandaj edhe objekt i këtij shkrimi do të jetë pikërisht kjo problematikë.

Do të përpiqemi t'i paraqesim dhe t'i analizojmë këtu disa nga karakteristikat më qenësore dalluese midis tyre (së paku nja 5 - 6 karakteristika), por pa pasur ndonjë pretendim shterues.

Mirëpo, para se të kalohet në çështjen e paralajmëruar, e shohim të udhës t'i përmendim, së pari, disa nga pikat më kryesore të përbashkëta a përkuese të tyre, duke u ndalur, më pastaj, shkurtimisht në çështjen e trajtimit të tyre në literaturën tonë gjuhësore dhe në atë të disa gjuhëve të tjera.

Pikat e përgjithshme përkuese të tyre mund t'i radhisim si më poshtë: së pari: lokucionet foljore dhe njësitë frazeologjike janë ndërtime të krijuara në periudha të ndryshme kohore nëpër të cilat ka kaluar shoqëria jonë, pra ato kanë karakter historik; së dyti: edhe njëra njësi edhe tjetra kanë përgjithësisht një shkallë të caktuar të qëndrueshmërisë së elementeve përbërëse; së treti: ato nuk krijohen në çastin e përdorimit, por riprodhohen në ligjërim si të gatshme; së katërti: ato kanë barasvlera të mundshme të shprehura me fjalë të vetme ose me togje fjalësh; dhe së fundi: mund të kenë përbërje strukturore përafërsisht të njëjtë a të ngjashme (nga fjalët emërtuese e shërbyese të pjesëve të ligjëratës).

Sipas mendimit tonë, këto veçori të përbashkëta kanë bërë që shumë studiues tanë të mos e vënë re dallimin në mes tyre, duke i konsideruar si të njëjta a të ngjashme etj. Prandaj, për shumikë lokucionet janë frazeologjizma dhe frazeologjizmat lokucione. Kështu, për shembull, në **Gramatikën e gjuhës shqipe I** (Tiranë, 1995, 2002), në faqen 260, togu **zë besë** është marrë si lokucion foljor, ndërsa në faqen 128 të këtij teksti si shprehje frazeologjike. Po kështu, në **Gramatikën e gjuhës shqipe II** (1997) ndërtime të *vë dorë, ngul këmbë* etj., konsiderohen si lokucione foljore (f. 183), kurse në **Gramatikën e gjuhës shqipe I** si shprehje frazeologjike (f. 128). Edhe J. Thomaj në monografinë e tij **Çështje të frazeologjisë së shqipes** (Tiranë, 1981), me gjithë përpjekjet që të rroket me këtë problematikë, nuk arrin t'i veçojë njësitë frazeologjike foljore nga lokucionet përkatëse, ngase të gjitha ndërtime të sipërsënuara i trajton si frazeologjizma, kurse lokucione i konsideron vetëm ato të pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës (te ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat etj.). Këto inkonsekuenca mund të vihen re edhe në disa studime e artikuj të ndryshëm, sa herë që bëhet fjalë për këto dy njësi leksiko - gramatikore. (Më konkretisht mund të shihen disa artikuj të Z. Dacit - Karapicit për disa tipe lokucionesh foljore, të botuar në **Studime filologjike** gjatë viteve 1985/86).

Në anën tjetër, një përpjekje e mirë për dallimin e lokucioneve dhe të njësive frazeologjike, në përgjithësi, është bërë nga ana e M. Domit në artikullin e tij me titull **Disa çështje të lokucioneve** (botuar në SF, 1/1985). Mirëpo edhe ky studiues në mungesë të kriterëve krejtësisht të qarta, nuk ka arritur të vendosë deri në fund një vijë ndarëse të qartë në mes tyre.

Edhe në gjuhët të tjera, për çudi, kjo çështje nuk është përcaktuar dhe shpjeguar në mënyrë krejtësisht të kënaqshme dhe të drejtë. Edhe këtu ndeshim disa inkonsekuenca terminologjike. P. sh. në gjuhët frënge kryesisht parapëlqehet të përdoret termi **locution**, në të cilin përfshihen gati të gjitha ndërtime të qëndrueshme, madje edhe ato të ashtuquajturat **les locutines tout faites**, si dhe ato me vlerë frazeologjike¹; në gjuhët sllave, në krye me rusishten, mbizotëron termi frazeologjizëm (ndoshta për vetë faktin se pikënisjet e para për këtë njësi leksikore e semantike i gjejmë pikërisht në studimet e gjuhëtarëve sovjetikë: Vinogradov, Beloshapkova, Fjodoruk etj., ndërmjet viteve 1938 - 1964). Një gjendje e këtillë mbizotëron pothuaj edhe në gjuhën gjermane. Në këtë të fundit, p. sh. fjala **Phrasologie** mbulohet me disa fjalë, si: **Idiom, Redensart, Redewendung, Phrasem**² etj.

¹Shih Maurice Rat, *Les locutions françaises*, Paris, 1966.

²Shih H. Glück - ut, *Metzler Lexikon Sprache*, Stuttgart, 2000, f. 529.

Kjo gjendje terminologjike e studimore e padefinuar në gjuhët e tjera, s'ka dyshim se është reflektuar, pra, edhe në studimet tona mbi këtë çështje, përgjithësisht.

Është fakt i pamohueshëm se ka mjaft vështirësi në dallimin i tyre, sidomos në përcaktimin e kufirit të atyre rasteve që janë në kapërcyell. Mirëpo, me gjithë vështirësitë që janë të pranishme në veçimin e tyre, ne mendojmë se, në bazë të disa karakteristikave të tyre më kryesore, të cilat do të mundohemi t'i parashtrojmë këtu më poshtë, ato mund dhe duhet të dallohen. Dhe në pamundësi që të merren shembuj nga të gjitha pjesët e ligjëratës, në këtë shkrim do të kufizohemi vetëm në sistemin foljor.

Së pari, **njësitë frazeologjike** foljore, marrë në përgjithësi, janë ndërtime të qëndrueshme, me përbërës kryesisht të pandashëm, me një shkallë relativisht të lartë monolociteti dhe me një rend të ngulitur të elementeve përbërëse. Çdo ndryshim fleksiv i trajtave të tyre, në mënyrë të veçantë të trajtës së emrit, (sepse emri në të shumtën e rasteve në këto ndërtime gjuhësore ka një trajtë të pandryshueshme) dhe, sidomos, çdo ndërrim i vendeve të tyre mund të ndryshojë kuptimin e tyre ose edhe t'i shkuptimësojë fare. Krahaso p. sh. **(e) mori lumi** dhe *pemët i mori lumi me vete*, **i doli boja** dhe *i doli mbi bojë...*, etj. Në anën tjetër, **lokucionet foljore** kanë një shkallë më të ulët të qëndrueshmërisë a të ngurtësisë së elementeve përbërëse. Këto të fundit mund të konsiderohen si ndërtime që janë në kapërcyell në mes ndërtimeve të qëndrueshme dhe bashkimeve të lira të fjalëve. Prandaj çdo ndryshim i rendit të fjalëve hap shteg për krijimin e togfjalëshave të lirë sintaksorë. Krahaso p. sh.: **ngul këmbë** dhe *ngul këmbën*; **marr pjesë** dhe *e marr pjesën time*; **kam dëshirë** dhe *(e) kam këtë dëshirë*; **kam shpresë** dhe *(e) kam shpresën te...*; etj.

Së dyti, **njësitë frazeologjike** foljore përdoren kryesisht me kuptime të figurshme, pra me kuptimin e tyre të dytë. Dhe kjo është veçoria më kryesore e tyre. P. sh.: frazeologjizmi **(ia) ktheu shpinën** /kurrizin/ përdoret me kuptimin *(e) braktisi, nuk kujdeset më për të*; frazeologjizmi **(ia) dha krahun (dorën) dikujt** përdoret me kuptimin *e ndihmoj dikë, e përkrahu dikë*; **(e) mori lumi** përdoret me kuptimin *mbaroi krejtësisht, humbi fare, dështoi* etj; **i doli boja** përdoret me kuptimin *u zbulua, s'është më aktual, i është çirur maska*; etj. Kuptimi figurativ i tyre, sikundër dihet, lidhet me figurat e njohura stilistike, siç janë: metafora, metoniamia, simboli, krahasimi, alegoria etj. Ndërsa, në anën tjetër, **lokucionet foljore** kryesisht përdoren me kuptimin e tyre të parë, jo të figurshëm. P. sh.: **vë re** përdoret me kuptimin *shoh me vëmendje e me një qëllim të caktuar, vështroj me kujdes e me një synim; vëzhgoj*³; **kam dëshirë** përdoret me kuptimin *dua; kam zell*⁴; **(Nuk) kam qejf** me kuptimin *(nuk) kam dëshirë, (nuk) dua*⁵; **i zë besë dikujt** me kuptimin *i besoj*⁶; **(më) ka ënda** me kuptimin *më pëlqen diçka; dua të kem, kam dëshirë për diçka*⁷; **marr pjesë diku** me kuptimin *bashkohem me të tjerët në një punë a veprimtari*⁸ etj. Pra, të gjitha këto lokucione foljore mund të kuptohen fare lehtë nga çdo shqipfolës, meqë përdoren me kuptimin e parë.

³FGJSSH, f. 2157.

⁴FGJSSH, f. 327.

⁵FGJSSH, f. 1591.

⁶FGJSSH, f. 126.

⁷FGSSH, f. 443.

⁸FGJSSH, f. 1493.

Së treti, **njësitë frazeologjike foljore**, në të shumtën e rasteve, e kanë një bazë të njohur a të panjohur motivuese. Kjo bazë motivuese zakonisht është e lidhur me momente të caktuara, ndodhi e ngjarje të ndryshme historike nëpër të cilat ka kaluar populli ynë. P. sh. t´i kthehemi edhe njëherë njësisë frazeologjike foljore (**ia**) **ktheu shpinën/ kurrizin dikujt**. Kuptimi i parë i kësaj njësie është *kur dikush dikujt thjesht ia kthen shpinën/ kurrizin, nuk qëndron ballë për ballë e sy më sy*. Kjo është baza motivuese. Dhe pikërisht mbi këtë bazë, ka dalë shumë më vonë kuptimi figurativ i saj, dhe i të gjitha të tjerave, në përgjithësi. Ndërsa, **për lokucionet foljore**, në përgjithësi, nuk mund të bëhet fjalë për këtë bazë motivuese. Por, një gjë është për t´u theksuar këtu: **Lokucione foljore** duhet të konsiderohen edhe idiomat e tipit si: **vë re, bëj zë, marr vesh, bëj pallë** etj., të cilat në të kaluarën e largët sigurisht se kanë pasur ndonjë bazë të njohur motivuese (p. sh. togu foljor **vë re** mendohet të ketë dalë nga *vë roje*). Mirëpo, ato sot mund të konsiderohen si ndërtime të demotivuar, në këtë aspekt. Ky fakt tregon se në mes lokucioneve dhe frazeologjizmave foljorë mund të hetohet një bashkëveprim në rrugën e formimit të tyre.

Së katërti, **njësitë frazeologjike foljore** janë më komplekse sa i përket zbrërthimit të tyre nga ana kuptimore, ngase shpeshherë ndodh që ato të kenë më shumë se një kuptim, varësisht nga konteksti i përdorimit të tyre P. sh.: frazeologjizmi (**m´u**) **bë gjaku ujë** përdoret me kuptimet:

- a) u frikësova, u tremba shumë;
- b) u shqetësova pa masë, u mërzita, u zemërova shumë⁹.

E tëra kjo lidhet me kontekstin e përdorimit. Por, të mos harrojmë se ky kompleksitet i zbrërthimit të tyre, në të shumtën e rasteve, del nga vetë kuptimi figurativ i tyre. Kurse **lokucionet foljore** janë më të thjeshta për t´u zbrërthyer dhe zakonisht kuptimi tyre del nga vetë përbërësit e tyre.

Së pesti, edhe barasvlerat e **njësive frazeologjike foljore** mund të sajohen nga kuptimet e tyre të mundshme figurative dhe mbi këtë bazë përcaktohet edhe vlera e tyre kategoriale foljore (p. sh. frazeologjizmi **m´u bë gjaku ujë** me strukturë fjalie, në analizën gramatikore e ka vlerën e një foljeje të vetme apo të një kallëzuesi të thjeshtë foljor). Por në qoftë se ne nuk ia dimë kuptimin a kuptimet e secilës njësi frazeologjike, atëherë nuk do të jemi në gjendje t´ua dimë as barasvlerat e tyre (shih më lart barasvlerat e tij) dhe kështu në këtë mënyrë ato nuk mund të përdoren në momente të caktuara të ligjëritimit. Kurse te **lokucionet foljore** nuk mbizotëron kjo vështirësi, sepse barasvlerat e tyre mund të nxirren më lehtë në të gjitha rastet, duke u mbështetur kryesisht në elementet e tyre përbërëse. Kështu p. sh. mund të përcaktohen barasvlerat sinonimike të lokucioneve foljore të tipit: **zë besë, kam shpresë, bëj ballë, jam i mendimit; vë re, bëj zë**; etj., duke u mbështetur në elementet përbërëse të tyre: nga gjymtyra emërore (= *besoj, shpresoj, përballoj, mendoj*), nga të dy fjalët përbërëse (= *vërej, bëzaj*) etj., mirëpo ka edhe ndonjë rast kur ekuivalencat nuk e kanë mbështetjen në asnjë fjalë nga lokucioni bazë (p. sh.: **marrë vesh** e ka kuptimin

⁹FGJSSH, f. 2081.

a) dëgjoj, marr njoftim për diçka;

b) nga diçka e njoh një punë, një çështje a një fushë të dijes, e kuptoj, e di¹⁰ etj.

Së gjashti, **te njësitë frazeologjike foljore** elementet përbërëse të tyre kanë kryesisht kuptim të plotë leksikor e të mëvetësishëm, ndërsa **te lokucionet foljore** mund të ndodh që një fjalë të ketë kuptim të mëvetësishëm, ndërsa tjetra të jetë në shërbim të saj, pra, si fjalë funksionale, si p. sh. foljet: **bëj, marr, vë** në ndërtimet: **bëj be (betohem), bëj çudi (çuditem), bëj durim (duroj), bëj dëm (e dëmtoj), bëj klasifikimin (klasifikoj), bëj ndryshime (ndryshoj), i bëj bashkë (i bashkoj), bëj gati (gatis), i bëj nder dikujt (e nderoj dikë)¹¹; marr hak (hakmerrem), mori frikë (u frikësua), marr për bazë (bazohen), marr nën mbrojtje (mbroj)¹²; i vë besë (i besoj); i vë kufi (e kufizoj), i vë theksin (e theksoj) etj.**

Prandaj, duke i marrë për bazë të gjitha këto që thamë deri këtu vijmë te përfundimi se ndërtimet frazeologjike foljore duhet të dallohen doemos nga lokucionet foljore jo vetëm sa i përket emërtimit i tyre, por edhe nga veçoritë përmbajtësore dalluese. Prandaj, të parat kushtimisht mund t'i quajmë edhe si ndërtime leksikore, sepse janë të kufizuara leksikisht në një gjuhë, janë kryesisht figurative, idiomatike etj., kurse lokucionet foljore, si ndërtime gramatikore, sepse janë më të gramatikalizuara, në përgjithësi.

Por në fund të mos harrojmë se kjo çështje nuk përfundon vetëm me kaq. Ajo duhet të studiohet nga shumë anë e aspekte për të sjellë edhe shumë veçori e karakteristika që nuk u përmenden në këtë shkrim.

¹⁰FGJSSH, f. 1063.

¹¹FGJSSH, f. 134.

¹²FGJSSH, f. 1062 - 1063.